


8 - Monitorimi në vazhdimësi i glukozës

Çfarë është matësi në vazhdimësi i glukozës (CGM)? CGM është pajisja që mat nivelet e glukozës në indin subkutan dhe paraqet tendencën e vlerave glicemike 24 orë në 24.

Cilët janë pjesët përbërëse?



Sensori dhe transmetuesi për mbledhjen e të dhënave.




Marrësi ose aplikacioni i smartphone për leximin e informacioneve të disponueshme.




Pranë vlerës së glukozës shfaqet shigjeta e tendencës që tregon si po ndryshon glicemia, ndërsa më poshtë mund të gjeni grafikun e tendencës së vlerave për orët e mëparshme.

Si funksionon?



Sensori subkutan detekton nivelet e glukozës në lëngun intersticial në intervale prej pak minutash. Informacioni i transmetohet marrësit/aplikacionit për të monitoruar tendencën e vlerave glicemike.

Si aplikohet?




Sistemet CGM mund të pozicionohen në abdomen ose në pjesën e pasme të krahut, në varësi të llojit të pajisjes. Shmangni zonat pranë kockave, me lëkurë të irrituar, me tatuazhe dhe zonat që goditen lehtësisht.

Kur përdoret?




Përdoret si pjesë e një procesi terapeutik me rekomandim mjeku. Disa modele mund të zëvendësojnë matjet me glukometër dhe mund të përdoren për të marrë vendime terapeutike.

Cilat janë ndryshimet me një glukometër?



Matja e glukozës pa qenë nevoja të shpohet gishti.*



Vizualizimi, ruajtja e vlerave të glicemisë dhe e tendencës së tyre gjatë ditës dhe natës.



Marrja e njoftimeve kur vlerat e glicemisë janë jashtë norme.

Glukoza matet në lëngun intersticial dhe jo në gjakun kapilar, për këtë arsye ekziston një vonesë prej disa minutash në lexim në krahasim me vlerat kapilare.

* Nëse leximet tuaja glicemike nuk përputhen me simptomat apo pritshmëritë, mund t'ju duhet të përdorni një glukometër për të marrë vendime terapeutike.